



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2020:032893

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05505991

P.nr.157/2014

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i përgjithshëm - Divizioni penal, Gjyqtari i vetëm gjykues, Besnik Sheqiri, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Izet Hyseni, në çështjen penale kundër të pandehurës: M. K., për shkak të veprës penale “Vjedhja e rëndë” nga neni 327 par. 1 nën-par. 1.2 të KPRK-së, e akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.nr.II.8919/2013, të datës 12.03.2014, pas përfundimit të seancës së hapur të shqyrtimit fillestar, në prezencë të prokurorit të shtetit Rukije Sheshivari, të pandehurës dhe mbrojtësit të saj të caktuar sipas detyrës zyrtare av. B. M., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 26.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

E pandehura,

M. K., nga i ati E. dhe nëna R., mbiemri i vajzërisë së nënës I., e lindur më, me vendbanim në rrugën “B. K.” Lakërishtë, Hy-..., K-..., nr. ..., Prishtinë, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion shitëse, e pa martuar, e gjendjes dobët ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, në vuajtje të dënimit për vepër tjetër penale.

Ë S H T Ë F A J T O R E

S e p s e :

Me datë 12.12.2013, rreth orës 11:45, në rrugën “Z. P.” në Podujevë, e pandehura me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetës apo personit tjetër ti sjell dobi pasurore të kundërligjshme, ka shkuar tek shtëpia e të dëmtuarës S. A., e pasi e njëjta e ka vë në lajthim se gjoja po kërkon shtëpinë e një fqiu të saj, ka kërkuar që e dëmtuara ta përcjellë deri tek hyrja e ndërtesës ku me të arritur aty, duke vepruar në mënyrë të rrezikshme dhe të vrazhdë, me forcë ka arritur të dëmtuarës të i shkaput zingjirin që e kishte të vendosur në qafë, në vlerë prej 250 euro, dhe me shpejtësi largohet nga vendi i ngjarjes.

- me këtë ka kryer veprën penale “Vjedhja e rëndë” nga neni 327 par. 1 nën-par. 1.2 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të nenit si më lartë dhe neneve 4, 7, 17, 41, 42, 43, 45, 46, 49, 50, 51, 52, 53, 73, 74, 75, 76 të KPRK-së, si dhe neneve 242, 364, 367, 452 par. 4 dhe 528 të KPPRK-së, të pandehurën e:

G J Y K O N

- I. Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, si dhe dënim me gjobë në shumën prej njëqind (100) Euro, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse në periudhën e verifikimit prej dy (2) viteve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e pandehura nuk kryen vepër tjetër penale.
- II. E pandehura lirohet nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve të procedurës penale nga neni 449, paragrafit 2, nën-paragrafët 2.1 deri në 2.6, dhe nën-paragrafit 2.9 të KPP-së, ngase pagesa e tyre do ta rëndonte gjendjen materiale të pandehurës apo të personave që ajo detyrohet t'i mbështes materialisht.
- III. Trashëgimtarët e të dëmtuarës S. A. tani e ndërë, trashëgojnë të drejtën e personit të dëmtuar vetëm për kompensim dëmi material, në kontest të rregullt juridiko civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën PP.nr.II.8919/2013, të datës 12.03.2014, kundër të pandehurës M. K., për shkak të veprës penale "Vjedhja e rëndë" nga neni 327 par. 1 nën-par. 1.2 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjyqtari i vetëm gjykues ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor më datë 21.03.2024, gjatë të cilës u dëgjuan Prokurori i Shtetit Rukije Sheshivari nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, e pandehura me mbrojtësin e saj të caktuar sipas detyrës zyrtare avokat B. M., ndërsa nuk ka prezantuar e dëmtuara S. A., për të cilën gjykata përmes Zyrës së Gjendjes Civile në Podujevë ka siguruar certifikatën e vdekjes nga e cila rezulton fakti se e dëmtuara S. A. ka vdekur me datë 01.01.2019 në Podujevë.

E pandehura në seancën e shqyrtimit fillestar pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e saj ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ka shprehur keqardhje dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëris apo kryej vepër tjetër penale, nga gjykata ka kërkuar një dënim sa më të butë penal.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se e pandehura e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga e pandehura pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e saj, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës sepse ky pranim fajësie është bërë konform dispozitave ligjore të KPP-së dhe ka mbështetje në shkresat e lëndës, gjykatës i propozoi që pranimin e fajësisë ta vlerësoj si rrethanë lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin.

Mbrojtësi i të pandehurës M. K., av. B. M., lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës ka deklaruar se pas konsultimit me të pandehurën lidhur me veprën penale e cila i vihet në barrë,

e njëjta shkurtimisht sqaroi rastin duke thënë se ka kaluar një kohë e gjatë nga kryerja e veprës penale dhe pavarësisht kësaj e njëjta e pranoi fajësinë dhe u zotua dhe premtoi para gjyqtarit, prokurorit dhe avokatit mbrojtës se asnjëherë më në jetën e saj nuk do të ndodh diçka e tillë, po ashtu sqaroi se asnjëherë më parë e deri në këtë rast nuk ka kryer vepra qoftë kundërvajtëse apo penale, gjykatës i propozoi që këto rrethana ti merr parasysh me rastin e caktimit të llojit të dënimit.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas pranimit të fajësisë nga e pandehura si dhe marrjes në konsideratë të pikëpamjeve të prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të pandehurës, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërteton se në veprimet inkriminuese të pandehurës të ndërmarra në kuadër të dashjes së saj, manifestohen të gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale “Vjedhja e rëndë” nga neni 327 par. 1 nën-par. 1.2 të KPRK-së, andaj pasi që më parë gjeti se në aspektin penalo-juridik është përgjegjëse, të njëjtën e shpalli fajtores dhe i shqiptoi sanksionin penal si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

E pandehura është shpallur fajtores për Veprën penale Vjedhja e rëndë nga neni 327 par. 1 nën-par. 1.2 të Kodit Nr. 04/L-082 Penal të Kosovës, për të cilën ligjvënësi ka përcaktuar sanksionin penal dënim me gjobë dhe burgim prej tre (3) deri në shtatë (7) vjet.

Konform nenit 75 par. 1 nën-par. 1.3 të KPRK-së është përcaktuar se: “Gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit “... në rastet kur kryesi pranon fajësinë ose ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë”.

Konform nenit 76 par. 1 nën-par. 1.3 të KPRK-së: “Kur ekzistojnë kushtet për zbutjen e dënimit nga neni 75 i këtij Kodi, gjykata mund të zbusë dënimin brenda kufijve në vijim “...nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej së paku tre (3) vjet, dënimi mund të zbutet deri në një (1) vit burgim”.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjyqtari i vetëm gjykues mori parasysh të gjitha rrethanat e mundshme lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 73 dhe 74 të KPRK-së të cilat janë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit, në rastin konkret si rrethana lehtësuese mori parasysh pranimin e fajësisë nga e pandehura në shqyrtim fillestar, restituimin e dëmit të shkaktuar viktimës sendi i vjedhur menjëherë i është kthyer të dëmtuarës, kohë e gjatë nga kryerja e veprës penale, me ç’rast deri në marrjen e këtij aktgjykimi kanë kaluar më tepër se dhjetë vite, pendimin e sigurtë dhe premtimin e të pandehurës se në të ardhmen nuk do të përsëris apo kryej vepra tjera penale, ndërsa si rrethana rënduese gjykata nuk gjeti andaj, mbi bazën e arsyeve dhe rrethanave të sipër theksuara vlerësoi se dënimi me kusht si dënim alternativ i shqiptuar të pandehurit, është adekuat dhe në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të tij, me bindje se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit me kusht i paraparë me nenin 50 të KPRK-së, i cili konsiston në risocializimin e të pandehurit me anë të pezullimit të dënimit, me të cilin dënim të pandehurit seriozisht i tërhiqet vërejtja dhe i bëhet me dije se nëse i njëjti kryen veprë tjetër penale brenda periudhës së verifikimit, gjykata do të revokojë dënimin me kusht dhe do të urdhërojë ekzekutimin e dënimit të caktuar në dënimin me kusht.

Vendimi mbi mundësinë e revokimit të dënimit me kusht është marrë në bazë të nenit 53 të KPRK-së.

Vendimi mbi lirimin nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale është marrë në bazë të nenit 452 par. 4 KPRK-së.

Vendimi për udhëzimin e trashëgimtarëve të dëmtuarës për të drejtën e kompensimit të dëmit material në kontest të rregullt juridiko civil është marrë në naze të nenit 528 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë dhe në bazë të neneve 242 dhe 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË,
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal
P.nr.175/2014 me Datë 26.03.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues
Besnik Sheqiri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.